



National Endowment
for Democracy
Supporting freedom around the world



ANALIZA E TRENDIT

QËNDRIMET E KOMUNITETIT SERB NË KOSOVË



NOVEMBAR 2022

PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse	3
Metodologjia e hulumtimit.....	4
Gjetjet kryesore të hulumtimit.....	5
Përshkrimi i mostrës.....	7
Rezultatet e hulumtimit/Qëndrimet e përgjithshme.....	9
Besimi në vendimmarrësit	17
Besimi në institucione.....	21
Qëndrimi ndaj pjesëmarrjes aktive në proceset politike në Kosovë.....	25
Liria e shprehjes dhe qasja në informacion.....	35
Siguria e qytetarëve.....	41
Tendencat e migrimit.....	45
Qëndrimet ndaj Bashkimit Evropian.....	51
Distanca etnike	55

INTRODUCTION

Hulumtimi vjetor i opinionit publik **Analiza e trendit** i realizuar nga OJQ AKTIV synon të paraqesë një pasqyrë të qartë të luhatjeve dhe ndryshimeve në pikëpamjet dhe qëndrimet e pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës për një sërë çështjesh përkatëse socio-politike. I zhvilluar për herë të parë në vitin 2016 në katër komunat që përbëjnë veriun e Kosovës, në vitin 2019 kërkimi u zgjerua për të mbuluar të gjitha komunat në Kosovë që janë me shumicë serbe. Ky publikim është unik ngaqë përbën një nga përpjekjet më gjithëpërfshirëse për të hedhur më shumë dritë mbi nevojat, prioritetet dhe gjithsesi shqetësimet e komunitetit serb të Kosovës. Analizat e shkuara kanë zbuluar masën dhe thellësinë e luhatjeve në marrëdhëniet (ose mungesën e tyre) ndërmjet serbëve dhe strukturave institucionale dhe qeverisëse të Kosovës, opinionet e tyre për aktorët kryesorë ndërkombëtarë dhe perceptimet e tyre për situatën e përgjithshme ekonomike dhe të sigurisë. Shumë nga këto modele dhe trende kanë qenë negative, ngase mund të shihet se ka rënie të dukshme në mesin e atyre që vlerësojnë pozitivisht të ardhmen e tyre, gjë që tregon se ka ndjenjë të përhapur pesimizmi kur bëhet fjalë për vlerësimet e perspektivave afatgjata të komunitetit serb të Kosovës. Nga ana tjetër, ajo që vihet re gjithashtu është një rënie e distancës etnike, me numër në rritje të respondentëve që thonë se ata jo vetëm që kanë pasur ndërveprim me komunitetin shumicë, por gjithashtu i konsiderojnë ato ndërveprime si neutrale ose pozitive për nga natyra.

Hulumtimi i këtij viti (2022) u krye në atmosferë tensionesh të shtuara dhe në praninë e ndjenjës në rritje se situata e sigurisë ishte në gjendje të përkeqësimit të ngadaltë. Ngjarjet që ndodhën gjatë vitit të shkuar, duke filluar me zgjedhjet për Kuvendin në shkurt të vitit 2021, kontribuuan në perceptimin në rritje se situata politike po shkonte në drejtim të gabuar. Vendimet e Qeverisë së Kosovës për targarat dhe dokumentet e identifikimit, dy çështje të cilat kishte kohë që po hidhnin hije mbi procesin e dialogut, u morën në kohën kur po kryhej ky hulumtim dhe padyshim ndikuan (të paktën pjesërisht) në rezultatet e tij. Gjithashtu viti i shkuar u shënua me retorikë gjithnjë e më e nxehtë të përdorur nga aktorët politikë kur bëhet fjalë për marrëdhëniet ndëretnike dhe mosrealizimin e të ashtuquajturit "dialog i drejtpërdrejtë" ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe serbëve. Është mjaft interesant fakti se, me sa duket, këta faktorë nuk kanë ndikuar negativisht në uljen e nivelit dhe frekuencës së kontakteve ndërmjet serbëve dhe komuniteteve të tjera, gjë që sugjeron se format profesionale dhe të tjera të komunikimit, bashkëveprimet dhe bashkëpunimet kanë vazhduar, në përgjithësi, të pandërprera pavarësisht nga baticat e zbatimit e zhvillimeve politike.

Situata aktuale është delikate dhe e paparashikueshme dhe **Hulumtimi i analizës së trendit** për vitin 2022 u zhvillua përpara shtatorit 2022 dhe për këtë arsye nuk pasqyron ngjarje që kanë ndodhur gjatë asaj periudhe të caktuar. Prandaj, mbetet për t'u parë se sa radikal ishte ndikimi që kanë pasur/kanë ato ngjarje në pikëpamjet e komunitetit të gjerë për sigurinë e tyre personale dhe perspektivat në Kosovë. Në themelin e rezultateve të këtij viti qëndron droja e përhapur që buron nga çështjet ende të pazgjidhura, siç është formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, si dhe një formë apatie që ka zënë rrënjë kur bëhet fjalë për potencialin për të arritur një zgjidhje afatshkurtër që do të ofronte mbrojtjen (si institucionale ashtu edhe tjetër) që është e nevojshme për të frenuar valën e migrimit të jashtëm. Sido që të interpretohen këto rezultate, ato duhet të shihen nga politikëbërësit dhe vendimmarrësit si rikujtim për nevojën urgjente për të nisur përpjekje të reja dhe gjithëpërfshirëse që synojnë përmirësimin e respektimit institucional të legjislativitetit që mbron të drejtat e komuniteteve jo-shumicë dhe gjithsesi ngritjen e cilësisë së jetës së tyre.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Mënyra e hulumtimit: sondazhi në terren ballë për ballë (*face-to-face*)

Instrumenti: pyetëtori i përbërë nga 42 pyetje

Periudha e hulumtimit: qershor - gusht 2022.

Periudha e hulumtimit:: 540

GJETJET **KRYESORE** TË HULUMTIMIT

7%

e të anketuarve konsiderojnë se situata në Kosovë po shkon në drejtim të duhur

70%

e të anketuarve konsiderojnë se nga akterët ndërkombëtarë, Rusia është mbrojtësi më i mirë i interesave të komunitetit serb në Kosovë

55%

e të anketuarve konsiderojnë se në tre vitet e ardhshme jeta e serbëve në Kosovë do të përkeqësohet

17.5%

e të anketuarve mbështesin vazhdimin e bisedimeve në Bruksel

13%

e të anketuarve mbështesin afishet si zgjidhje të problemit të targave të veturave

4%

e të anketuarve konsiderojnë se qëndrimet e pavarura dhe mendimi kritik nuk janë mjaftueshëm të përfaqësuar në mediat në Kosovë

67%

e të anketuarve thonë se në Kosovë nuk ka parti politike apo politikanë të cilëve u besojnë

4%

e të anketuarve mbështesin idenë e ndryshimit të kufijve

92%

e të anketuarve posedojnë ndonjë dokument personal të lëshuar nga institucionet kosovare

53%

e të anketuarve kanë qëndrim negativ ndaj BE-së

PËRSHKRIMI I MOSTRËS

Struktura e mostrës sipas gjinisë së të anketuarve

● burra

● gra




Struktura e mostrës sipas vendbanimit të të anketuarve

● Veriu i Kosovës

● Komunitatet me shumicë serbe në jug të lumit Ibër




Struktura e mostrës sipas arsimit të të anketuarve



Struktura e mostrës sipas moshës së të anketuarve



Struktura e mostrës sipas statusit të punësimit të të anketuarve




REZULTATET
E **HULUMTIMIT**

	NOTA MESATARE		
	2020	2021	2022
GJENDJA POLITIKE NË KOSOVË	2,06	2,01	2,05
GJENDJA EKONOMIKE NË KOSOVË	2,08	2,2	2,07
GJENDJA E SIGURISË NË KOSOVË	2,17	1,93	2,04
GJENDJA JUAJ MATERIALE	2,84	2,74	2,6


Të dhënat nga hulumtimi i këtij viti tregojnë se kënaqëshmëria me gjendjen aktuale politike, ekonomike dhe të sigurisë në Kosovë është shumë e ulët. Krahasuar me hulumtimet e vitit 2020 dhe 2021, vërehet një rënie shtesë e kënaqësisë lidhur me gjendjen materiale të të anketuarve. Të dhënat e nxjerra në tre vitet e fundit tregojnë për një trend definitiv të rënies së fuqisë financiare të qytetarëve serbë në Kosovë. Arsyet për këtë janë sigurisht ato të brendshme (veprimtaria e dobët ekonomike, segregimi ekonomik, sistemi ligjor jofunksional), por edhe të jashtme (pasojat ekonomike të shkaktuara nga kriza Covid-19 dhe lufta në Ukrainë). Shikuar në mënyrë kumulative, perceptimi i përgjithshëm i aspekteve të ndryshme themelore të jetës në Kosovë është shumë i keq.

Gjendja politike në Kosovë




Me vëzhgimin e segmentimit në bazë të vendbanimit, mund të vërejmë se qytetarët në jug të lumit Ibër e vlerësojnë gjendjen politike si më të mirë në krahasim me të anketuarit nga veriu i Kosovës. Përderisa 75% e të anketuarve nga veriu i Kosovës e vlerësojnë gjendjen politike si të keqe, të anketuarit në jug të lumit Ibër kryesisht pajtohen me këtë perceptim të gjendjes politike, mirëpo frekuenca e këtij perceptimi është më e ulët për pak më shumë se 10% se sa në mesin e të anketuarve nga veriu i Kosovës. Në krahasim me vitin e kaluar, nuk ka devijime të mëdha në rezultatet e fituara, gjë që na tregon se për një vit gjendja politike në Kosovë nuk ka ndryshuar dukshëm.

The economic situation in Kosovo




Sa i përket perceptimit të situatës ekonomike, nuk ka dallime të theksuara ndërmjet qytetarëve në veri dhe jug të lumit Ibër. Gjendja ekonomike në të dyja mjediset u vlerësua si shumë e keqe. Megjithatë, në krahasim me vitin e kaluar, vërehet një rënie e dukshme e kënaqësisë sa i përket gjendjes ekonomike tek të anketuarit nga veriu i Kosovës. Përderisa në vitin e kaluar përqindja e të anketuarve që vlerësuan gjendjen ekonomike si të keqe ishte rreth 53%, kjo përqindje këtë vit është rreth 70%.

Gjendja e sigurisë në Kosovë




Siguria, si një nga pikat veçanërisht të dhimbshme në jetën e serbëve në Kosovë, gjithashtu tregon ndryshueshmëri të konsiderueshme në varësi të vendbanimit. Pothuajse 85% e të anketuarve që jetojnë në veri të Kosovës e vlerësojnë gjendjen e sigurisë në Kosovë si të keqe, krahasuar me 55% të të anketuarve që jetojnë në jug të lumit Ibër. Mund të vërehet se këtë vit, në krahasim me vitin e kaluar, vlerësimi negativ i sigurisë në mesin e të anketuarve në jug të lumit Ibër ka rënë për rreth 12%, ndërsa tek të anketuarit nga veriu i Kosovës perceptimi ka mbetur në nivel të ngjashëm.

Gjendja juaj materiale




Përjetimi i gjendjes materiale të të anketuarve nuk mund të ndahet nga konteksti i pakonsoliduar politik, ekonomik dhe i sigurisë në të cilin jetojnë individët dhe familjet në veri dhe në jug të lumit Ibër. Siç tregojnë të dhënat, vetëm 2% e të anketuarve e perceptojnë gjendjen e tyre financiare si të shkëlqyer. Në krahasim me vitin e kaluar, mund të vërehet një rritje e numrit të të anketuarve që konsiderojnë se gjendja e tyre materiale është shumë e keqe. Vitin e kaluar kjo përqindje ishte ndërmjet 12.6% dhe 13%, ndërsa këtë vit varion ndërmjet 17.5% dhe 18.9%. Rritja vjetore prej madje 5% e atyre që e perceptojnë gjendjen e tyre financiare si tejet të palakmueshme, është e dhëna që tregon se ekziston një problem i rëndë socio-ekonomik. Këto të dhëna, të kombinuara me të dhënat që kanë të bëjnë me perceptimin e situatës së përgjithshme ekonomike në Kosovë, qytetarëve të nacionalitetit serb në Kosovë nuk i japin arsye për optimizëm financiar.

Sipas mendimit tuaj, a janë duke u zhvilluar gjërat në Kosovë në drejtim të duhur?



Edhe pse në vitin 2020 performanca politike dhe ekonomike në Kosovë u vlerësua pothuajse identike me vitin 2022, pyetja se në cilin drejtim po lëviz Kosova zbulon një trend të dukshëm. Gjegjësisht, nga viti 2020 e deri më sot, përqindja e të anketuarve që besojnë se Kosova po shkon në drejtimin e duhur është përgjysmuar nga 14% në 7%. Nga situata në të cilën në vitin 2020 çdo i shtati i anketuar besonte se Kosova po ecën në drejtimin e duhur, kemi arritur në atë pikë ku në vitin 2022 vetëm çdo i katërbëdhjeti i anketuar ndan një qëndrim optimist për të ardhmen e Kosovës.


Sipas mendimit tuaj, jeta për serbët në Kosovë pas tre vjetësh do të jetë:



- MË E MIRË
- NJËSOJ SI TANI
- MË E KEQE


Në përputhje me të dhënat për perceptimin e jetës së përgjithshme në Kosovë, hulumtimi i sivjetshëm tregon se ka pasur një rritje të numrit të të anketuarve që besojnë se jeta për serbët në Kosovë në tre vitet e ardhshme do të përkeqësohet edhe më shumë. Në krahasim me vitin e kaluar, bëhet fjalë për një rritje të konsiderueshme madje prej 16%. Nëse këtyre të dhënave i shtojmë faktin se vetëm 7% e të anketuarve besojnë se jeta në Kosovë në vitet e ardhshme do të jetë më e mirë, fitojmë një pasqyrë më të qartë të mungesës së shpresës, frikës dhe pesimizmit të pranishëm që dominojnë perceptimet e qytetarëve në veri dhe në jug të lumit Ibër.

Sipas mendimit tuaj, jeta për serbët në Kosovë pas tre vjetësh do të jetë:




Nëse e segmentojmë këtë pyetje sipas grupmoshave, fitojmë pasqyrime që tregojnë se të anketuarit më të vjetër, domethënë pjesëtarët e brezit 66+, janë më pak pesimistë. Kjo e dhënë ndoshta mund të shpjegohet nga akomodimi vetëdijes dhe ndërrijes, dhe duke u mësuar me një kontekst jete që nuk ofron shumë. Në anën tjetër, posaçërisht shqetësues është fakti se çdo i gjashti i anketuar që i përket grupmoshës 18 deri në 29 vjeç beson se situata në Kosovë do të përkeqësohet në tre vitet e ardhshme. Nëse kjo ndjenjë pesimiste lidhet me rritjen e mundësive dhe motivimit për t'u larguar nga Kosova, duket se në vitet e ardhshme problemi i shpopullimit dhe largimi i të rinjve do të bëhet gjithnjë e më akut për komunitetin serb në Kosovë. Duke krahasuar të dhënat e nxjerra nga hulumtimi i vitit paraparak, shihet se në të gjitha grupmoshat, përveç tek më të moshuarit, ka pasur rritje të ndjeshme të numrit të atyre që besojnë se jeta në Kosovë në tre vitet e ardhshme do të jetë edhe më e keqe. Bëhet fjalë për një rritje nga 14% (30-45 vjeç) në 22% (45-65 vjeç).

Sipas mendimit tuaj, jeta për serbët në Kosovë pas tre vjetësh do të jetë:



Kur më tej kjo pyetje analizohet sipas vendbanimit, vërehet se nuk ka dallime të theksuara ndërmjet banorëve të veriut të Kosovës dhe banorëve në jug të Ibrit. Dallimi mund të shihet nëse përgjigjet në këtë pyetje nga anketa e sivjetme krahasohen me ato të vitit të kaluar. Gjegjesisht, të dhënat tregojnë se numri i konsiderueshëm i të anketuarve që vitin e kaluar menduan se gjërat do të mbeten të pandryshuara, këtë vit perspektiva e status quo ka kaluar në perspektivë pesimiste. Në mesin e të anketuarve në veri të Kosovës, kemi të bëjmë me një ndryshim statistikisht domethënës të perspektivës. Bëhet fjalë për rreth 20% të të anketuarve që kanë ndryshuar përgjigjen nga “jeta për serbët do të jetë e njëjtë si tani” në “jeta për serbët do të përkeqësohet”. Kur bëhet fjalë për të anketuarit në jug të Ibrit, për një vit perspektiva pesimiste për të ardhmen u rrit për 12%.


Sipas mendimit tuaj, cili është problemi më i madh në Kosovë?



Kriza ekonomike e shkaktuar nga pandemia e Covid-19 dhe lufta në Ukrainë gjithashtu kanë prekur shoqëri shumë më të qëndrueshme dhe më të begata se sa Kosova. Duke marrë parasysh këtë rrethanë, nuk është për t'u habitur që në Kosovë vetëm për një vit është shënuar rritje drastike e shqetësimeve të qytetarëve për gjendjen ekonomike dhe papunësinë. Një rritje prej 40% tregon për krizën ekonomike gjithnjë e më të ashpër, të shoqëruar me një normë të lartë inflacioni, rritje të çmimeve të ushqimeve bazë dhe frikë për probleme të mundshme me furnizimin me energji elektrike. Humbja e vlerës së parasë që qytetarët e ndiejnë çdo ditë gjatë transaksioneve të zakonshme ditore rrit shqetësimin se sistemi i brishtë ekonomik i Kosovës nuk mund t'i shmangët një krizë financiare edhe më të madhe në muajt e ardhshëm.

BESIMI NË
VENDIMARRËSIT


Sa shpesh ndiqni zhvillimet politike?



Kur bëhet fjalë për informimin, hulumtimi i këtij viti tregon se ka pasur rritje të frekuencës së ndjekjes së ngjarjeve politike për 8% krahasuar me vitin e kaluar. Arsyet për këtë ndoshta lidhen me frikën globale në rritje të shkaktuar nga lufta në Ukrainë, si rezultat i së cilës të anketuarit ishin të nxitur për t'u informuar më shumë për marrëdhëniet ndërkombëtare. Krahas kësaj, kriza ekonomike në rritje gjithashtu ka inkurajuar edhe qytetarët që të jenë më të informuar.


A ka politikanë apo parti politike në Kosovë në të cilët keni besim?

● jo ● po ● Nuk e ndjekni politikën mjaftueshëm për t'u përgjigjur



Besimi te politikanët është një nga themelet thelbësore të çdo komuniteti të suksesshëm politik, veçanërisht kur bëhet fjalë për komunitetet me trashëgimi të pazgjidhur të luftës. Këto shoqëri, të cilave i përket edhe shoqëria kosovare, kërkojnë shkallë më të madhe besimi për ta nxjerrë shoqërinë nga faza traumatike dhe mosbesuese (pos)konfliktuozë. Matja shumëvjeçare e pulsit të qytetarëve të nacionalitetit serb në Kosovë përmes realizimit të sondazhit tonë tregon se në dy vitet e fundit besimi ndaj politikanëve në Kosovë ka rënë edhe më shumë.

Përqindja e atyre që theksuan se nuk ka politikanë apo parti politike në Kosovë të cilave u besojnë




Të dhënat tregojnë se mosbesimi ndaj politikanëve është i shpërndarë në mënyrë të barabartë në grupmosha të ndryshme, por është më i larti në mesin e të anketuarve që i përkasin grupmoshës 30-45 vjeç. Shkalla e besimit është e ulët jo vetëm për politikanët shqiptarë, por edhe për ata serbë. Në sondazhin e këtij viti, vetëm 8% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë besim në Listën Serbe, ndërsa vitin e kaluar kjo përqindje ishte 10%.

politikanët serbë	%	politikanët shqiptarë	%
LISTA SERBE (SRPSKA LISTA)	8%		0%
GRADANSKA INICIJATIVA SRPSKI OPSTANAK	0,3%		0%

BESIMI NË
INSTITUCIONE

A posedoni ndonjë dokument personal të lëshuar nga institucionet kosovare?



Një analizë krahasuese e gjashtë cikleve të fundit të hulumtimeve tona tregon se që nga viti 2017, përqindja e të anketuarve të komunitetit serb që kanë ndonjë dokument personal të lëshuar nga institucionet kosovare është rritur për 33%, kështu që sot ajo përqindje është pak më shumë se 90%.


Në një shkallë prej 1 deri në 5, vlerësoni sa jeni të kënaqur me punën/performancën e institucioneve të mëposhtme:

	NOTA MESATARE		
	2020	2021	2022
ORGANET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES LOKALE	2.56	2.59	2.55
KOMUNAT ME SISTEM KOSOVAR NË MJEDISJET SERBE	2.45	2.60	2.50
ZYRA PËR KOSOVË DHE METOHI	2.54	2.82	2.74
QEVERIA E SERBISË	2.89	3.22	3.07
QEVERIA E KOSOVËS	1.95	1.73	1.77
DEPUTETËT SERB NË KUVENDIN E KOSOVËS	2.12	2.21	2.14
MINISTRAT SERB NË KUVENDIN E KOSOVËS	2.12	2.25	2.08
UNMIK	2.19	1.95	2.08
ZYRA E BE-SË NË KOSOVË	2.09	1.95	1.99
EULEX	1.96	1.79	1.96
KFOR	2.23	2.09	2.31

Tri institucionet e vlerësuara me notë më të lartë nga qytetarët e kombësisë serbe janë Qeveria e Republikës së Serbisë, Zyra për Kosovë dhe Metohi dhe Organet e Përkohshme të Vetëqeverisjes Lokale. Edhe pse të tria institucione shënuan një rënie të lehtë, ato janë ende shumë më të vlerësuara se çdo institucion i Kosovës. Një e dhënë që ia vlen të theksohet i referohet rritjes së kënaqësisë me veprimet e KFOR-it në krahasim me vitin e kaluar.

Cili nga faktorët kryesorë ndërkombëtarë, sipas jush, është mbrojtësi më i mirë i interesave të serbëve të Kosovës?


● 2020 ● 2021 ● 2022



Specifik në shumë aspekte në marrëdhëniet ndërkombëtare, viti 2022 nuk solli ndryshime të rëndësishme në qëndrimet e qytetarëve serbe të Kosovës kur bëhet fjalë për akterët ndërkombëtarë. Pavarësisht situatës së sapokrijuar me agresionin e Rusisë kundër Ukrainës dhe pasojave të mundshme që mund të kenë aktivitetet e luftës ruse në pozitën dhe perceptimin e statusit të ardhshëm të Kosovës, në sytë e të anketuarve të kombësisë serbe në Kosovë, Rusia mbeti e perceptuar si mbrojtësja më e mirë e interesave të serbëve të Kosovës.

QËNDRIMI NDAJ
PJESËMARRJES AKTIVE
NË PROCESET POLITIKE
NË KOSOVË


Cili është qëndrimi juaj rreth vazhdimit të negociatave/bisedimeve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës nën patronazhin e BE-së?



- E MBËSHTES
- NUK E MBËSHTES
- NUK KAM QËNDRIM

Nga një këndvështrim krahasues, hulumtimi i vitit 2022 tregon se numri i të anketuarve që nuk kanë qëndrim dhe të atyre që mbështesin bisedimet në Bruksel ka rënë, ndërsa është rritur numri i të anketuarve që nuk e mbështesin vazhdimin e bisedimeve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës nën patronazhin e Bashkimit Evropian. Kjo e dhënë përputhet me shkallën e zvogëluar të interesimit dhe mungesën e motivimit të të gjitha palëve për pjesëmarrje në këto bisedime, gjë që dukshëm bartet edhe tek vetë qytetarët.


Si do të ndikojë në komunitetin serb në Kosovë vazhdimi i bisedimeve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës?



- ÇDO GJË DO TË MBETET E NJËJTË
- DO TË PËRKEQËSOJË CILËSINË E JETËS SË KOMUNITETIT SERB
- DO TË PËRMIRËSOJË CILËSINË E JETËS SË KOMUNITETIT SERB


Rënia e mbështetjes për vazhdimin e bisedimeve është e lidhur ngushtë me perceptimin e efekteve që mund të ketë dialogu në cilësinë e jetës së serbëve të Kosovës. Duke analizuar perceptimet e të anketuarve, mund të shohim se në vitin e fundit ka pasur rritje të konsiderueshme të numrit të të anketuarve të cilët besojnë se vazhdimi i bisedimeve do të çojë në një rënie shtesë të cilësisë së jetës së pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë. Në sondazhin e këtij viti, këtë lloj skepticizmi ndaj pasojave të vazhdimit të bisedimeve në Bruksel e kanë shprehur 15% më shumë të anketuar se në sondazhin e vitit të kaluar.

A do të formohet Asociacioni i komunave serbe?




Gjithashtu, të dhënat tregojnë se pothuajse çdo i gjashti i anketuar nuk beson se do të formohet Asociacioni i komunave serbe. Këto të dhëna janë të ngjashme me të dhënat e vitit 2020 dhe për rreth 10% më të larta se vitin e kaluar. Krahasuar me vitin e kaluar, optimizmi lidhur me formimin e Asociacionit të komunave serbe ka rënë dukshëm, gjë që lidhet edhe me agjendën e sivjetshme të komunikimit, si të autoriteteve në Serbi ashtu edhe në Kosovë.

Sipas jush, a janë afishet (stikerët) e targave një zgjidhje e mirë për problemin e lëvizjes së lirë të veturave?




Të dhënat e nxjerra nga ky hulumtim tregojnë se vetëm 13% e të anketuarve mbështesin afishet si zgjidhje të problemit me targat e veturave. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se çdo i treti i anketuar nuk është i sigurt për zgjidhjen në fjalë dhe nuk mund të shprehë mendimin e tij.

Sipas jush, a janë afishet (stikerët) e targave një zgjidhje e mirë për problemin e lëvizjes së lirë të veturave?



Rrethanat e ndryshme të jetës dhe "afërsia" me Serbinë sigurisht që ndikojnë në qëndrimet e ndryshme për shumë çështje mes serbëve që jetojnë në veri dhe atyre që jetojnë në jug të lbrit. Në këtë aspekt, duhet kuptuar edhe qëndrime të ndryshme kur bëhet fjalë për mbështetjen e zgjidhjes me afisha të targave të veturave. Përderisa çdo i pesti i anketuar në jug të lbrit mbështet politikën e afisheve të targave të veturave, vetëm çdo i njëzetë i anketuar në veri të Kosovës mbështet këtë zgjidhje.

A keni pasur ndonjë problem në vendkalimet administrative (Jarinje, Bërnjak, Dheu i Bardhë, Merdare, Hani i Elezit) në nëntë muajt e fundit (pas marrëveshjes për aplikimin e afisheve)?



Të dhënat tregojnë se një numër i vogël i të anketuarve, vetëm 4.5%, kanë pasur problem në vendkalime për shkak të zgjidhjes me afisha të targave të veturave.

A do të arrijnë marrëveshje Beogradi dhe Prishtina për energjinë deri në fund të vitit 2022?

Mosbesimi dhe pasiguria janë elemente të shpeshta ndërtuese të qëndrimeve të shumicës së serbëve në Kosovë. Kur bëhet fjalë për marrëveshjet e shumta që duhet të arrihen, përfshirë marrëveshjen për energjinë, nuk ka arsye të forta për të besuar se ato do të arrihen apo jo. Duke u mbështetur në përvojën e deritanishme negative, shumica e të anketuarve besojnë se marrëveshja nuk do të arrihet këtë vit.




Si do të ndikonte një marrëveshje e mundshme energjetike në jetën e serbëve në Kosovë?




Perceptimi i efekteve të marrëveshjes së mundshme për energjinë në mesin e të anketuarve është shumë negativ. Pothuajse çdo i dyti i anketuar beson se një marrëveshje e mundshme për energjinë do të kishte ndikim negativ për serbët në Kosovë, ndërsa vetëm çdo i dhjeti i anketuar beson se marrëveshja mund të ketë ndikim pozitiv.

Si do të ndikonte një marrëveshje e mundshme energjetike në jetën e serbëve në Kosovë?




Vëzhguar në mënyrë të segmentuar, të dhënat tregojnë se të anketuarit nga veriu i Kosovës janë më shumë se dy herë më negativë sa i përket perceptimit të tyre për efektet e marrëveshjes për energjinë në krahasim me të anketuarit që jetojnë në jug të Ibrit.

Si do të ndikonte një marrëveshje e mundshme energjetike në jetën e serbëve në Kosovë?




A e mbështetni idenë e demarkacionit?



Gjatë viteve të fundit janë nisur shumë iniciativa lidhur me zgjidhjen e statusit të Kosovës, e njëra prej tyre kishte të bënte me mundësinë e demarkacionit apo ndryshimit të kufijve. Megjithatë, të dhënat tregojnë se qarkullimi i kësaj ideje në publik nuk ka sjellë mbështetje të madhe të qytetarëve. Në fakt, një numër shumë i vogël i të anketuarve e mbështesin këtë platformë, ndërsa shumica e të anketuarve nuk e mbështesin atë ose nuk kanë informacion të mjaftueshëm për të pasur një opinion të informuar dhe për të marrë një vendim të informuar.


A e mbështetni idenë e demarkacionit?

● VERIU I KOSOVËS ● KOMUNAT ME SHUMICË SERBE NË JUG TË LUMIT IBËR



Dallimet e prodhuara nga topografia specifike dhe dinamika sociale e territoreve të banuara me serb në Kosovë shpesh krijojnë besime dhe qëndrime të ndryshme lidhur me çështjet themelore siç është ideja e demarkacionit. Në këtë kuptim, kur është fjala për demarkacionin, të dhënat nga hulumtimi ynë tregojnë për një dallim domethënës ndërmjet qëndrimeve të serbëve në veri të Kosovës dhe serbëve në jug të Ibrit. Të anketuarit që jetojnë në veri të Kosovës janë dukshëm më të hapur ndaj idesë së ndryshimit të kufijve sesa të anketuarit që jetojnë në jug të Ibrit. 23% e të anketuarve nga veriu i Kosovës janë të hapur ose e mbështesin këtë ide, krahasuar me vetëm 10% të të anketuarve nga territoret në jug të Ibrit.


Si do të ndikonte një demarkacion i mundshëm në vendimin tuaj për të qëndruar në Kosovë?



Para disa vitesh kemi parashtruar pyetjen lidhur me pasojat e miratimit eventual të një marrëveshjeje të bazuar në demarkacion, që na mundëson monitorimin dhe vëzhgimin e tendencave të caktuara. Pasqyra e sivjetshme tregon se në tre vitet e fundit është rritur numri i të anketuarve që pretendojnë se marrëveshja për demarkacionin nuk do të ndikonte në vendimin e tyre për të qëndruar në Kosovë, ndërsa numri i të anketuarve që theksojnë se si rezultat i një marrëveshjeje do të merrnin një vendim për të lënë vendbanimin e tyre aktual është në rënie.

Pos që Kosova të mbetet në sistemin kushtetues dhe juridik të Serbisë, cili nga skenarët e ofruar për një marrëveshje të mundshme gjithëpërfshirëse ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës do të ishte më i pranueshëm për serbët e Kosovës?

● 2020 ● 2021 ● 2022




Skenarët e ofruar për zgjidhjet e mundshme të statusit të Kosovës, padyshim që nuk gjejnë miratim tek qytetarët e kombësisë serbe. Të anketuarit para së gjithash refuzojnë zgjidhjet e propozuara, dhe më pas zgjedhin formimin e Asociacionit të komunave serbe ose opsionin e status quo. Shkëmbimi i territoreve dhe njohja e pavarësisë kanë një përqindje shumë të ulët mbështetjeje. Në tre vitet e fundit ka një trend në rritje të refuzimit të çdo zgjidhjeje, por edhe një trend të rënies së mbështetjes për formimin e Asociacionit të komunave serbe si zgjidhje përfundimtare. Kjo nuk do të thotë se qytetarët e nacionalitetit serb nga Kosova nuk e përkrahin Asociacionin e komunave serbe, por do të thotë se Asociacioni i komunave serbe si zgjidhje përfundimtare nuk i përmbush interesat e tyre.

LIRIA E SHPREHJES
DHE **QASJA** NË
INFORMACION

Ju krijoni një opinion për politikën dhe ngjarjet politike bazuar në:

● 2020 ● 2021 ● 2022



Vitet e fundit, ka pasur një rritje të dukshme të të anketuarve të cilët gjithnjë e më shumë i bazojnë pikëpamjet e tyre politike në informacionin që marrin nga media, si dhe në opinionet dhe pikëpamjet e familjes, miqve dhe kolegëve. Roli i institucioneve dhe politikanëve është konstant i vogël dhe i papërfillshëm.


Nga cilat media informoheni më shpesh?

MEDIAT TRADICIONALE (TV, RADIO) ●

MEDIAT E SHKRUARA (GAZETA) ●

PORTALET E SHTËPIVE MEDIATIKE ●

RRJETET SOCIALE (FACEBOOK, TWITTER...) ●




Due to respondents' increasing technological and digital literacy, there is a noticeable turn towards online sources of news. This trend is accompanied by a reduced role of traditional media (TV, radio, newspapers) and an increase in information received from social networks. In the future, we can undoubtedly expect a further acceleration of this trend, especially if we consider the limited offer of traditionally marketed media content in Kosovo.

Në një shkallë nga 1 deri në 5, sa ju besoni:

	2020	2021	2022
MEDIAVE ME NJË FREKUENCË KOMBËTARE NGA BEOGRADI	2,85	3,29	3,35
MEDIAVE TË PAVARURA NGA BEOGRADI	2,69	3,12	2,97
MEDIAVE SERBE NË KOSOVË	2,79	2,82	2,92
MEDIAVE NË GJUHËN SHQIPE NË KOSOVË	1,61	1,57	1,6


Besimi në media oscilon pak në tre vitet e fundit. Të anketuarit më së paku kanë besim në mediat në gjuhën shqipe, të ndjekura nga mediat serbe në Kosovë, pastaj mediat e pavarura nga Beogradi, ndërsa besimin më të madh kanë në mediat me frekuencë kombëtare nga Beogradi. Vëzhguar brenda një periudhe kohore prej tre vitesh, shihet se krahasuar me vitin 2020, ka një trend të lehtë të rritjes së besimit në mediat me frekuencë kombëtare nga Beogradi, mediat e pavarura nga Beogradi dhe mediat serbe në Kosovë.

A janë të përfaqësuar mjaftueshëm pikëpamjet e pavarura dhe mendimi kritik në mediat në gjuhën serbe në Kosovë?



Çdo i gjashtë i anketuar beson se pikëpamjet e pavarura dhe mendimi kritik nuk janë të përfaqësuar mjaftueshëm në mediat në gjuhën serbe në Kosovë. Krahasuar me vitin e kaluar, kemi të bëjmë me një rritje prej 15% kur bëhet fjalë për perceptimin e tillë për lirinë e medias dhe përmbajtjen mediatike. Në anën tjetër, ka një rritje të dukshme prej 10% kur është fjala për numrin e të anketuarve që pohojnë se pikëpamjet e pavarura dhe mendimi kritik janë mjaft të përfaqësuar në mediat në gjuhën serbe në Kosovë.


A ndiheni të lirë të shprehni publikisht qëndrimet tuaja politike?



Konteksti i përgjithshëm socio-politik që sundon në Kosovë me vite të tëra, sigurisht se nuk është një terren pjellor për të nxitur autonominë e opinionit dhe lirinë e shprehjes. Megjithatë, në tre vitet e fundit, ka pasur një tendencë të dukshme të rritjes së besimit të të anketuarve se ata ndjehen të lirë të shprehin publikisht pikëpamjet e tyre politike. Krahasuar me vitin 2020, ka pasur një rritje prej gati 10% dhe tani tre nga katër të anketuar pohojnë se ndjehen të lirë të shprehin publikisht pikëpamjet e tyre politike.


SIGURIA E
QYTETARËVE

A ka ndryshuar gjendja e sigurisë në Kosovë në vitin e fundit?




Perceptimi për situatën e sigurisë në Kosovë nga qytetarët serb ka ndryshuar në tre vitet e fundit. Krahasuar me vitin 2020, hulumtimi i këtij viti tregon se janë 10% më pak të anketuar që besojnë se gjendja e sigurisë në Kosovë është përkeqësuar.

A është cenuar siguria juaj apo siguria e familjes suaj të ngushtë gjatë vitit të kaluar?




Sipas mendimit tuaj, cilat janë rreziqet më të mëdha të sigurisë në rrethin tuaj?



Parë në retrospektivë, çdo vit të anketuarit gjithnjë e më shumë theksojnë paqëndrueshmërinë politike si rrezikun më të madh të sigurisë në mjedisin e tyre. Në tre vitet e fundit, perceptimi i destabilitetit politik si rreziku kryesor i sigurisë është rritur me 8%. Nga ana tjetër, në krahasim me vitin e kaluar, incidentet ndëretnike për 10% më pakë janë shënuar si rreziqe të sigurisë. Gjithashtu, vihet re se ka më pak referim për krimin si burim pasigurie.


Sipas mendimit tuaj, cilat janë rreziqet më të mëdha të sigurisë në rrethin tuaj?



E analizuar në bazë të vendbanimit, kjo pyetje na ndihmon të kuptojmë më mirë kontekstin e ndryshëm të sigurisë në të cilin jetojnë serbët në veri të Kosovës dhe serbët në jug të lumit Ibër. Paqëndrueshmëria politike perceptohet pothuajse njëjloj si rrezik i sigurisë nga serbët në veri të Kosovës dhe ata në jug të lumit Ibër. Megjithatë, dallimet domethënëse vijnë në pah kur shikohen incidentet dhe krimet ndëretnike. Gjegjesisht, të dhënat tregojnë se incidentet ndëretnike janë një problem dukshëm më i madh për serbët në jug të Ibër, ndërsa për serbët në veri të Kosovës krimi është një problem dukshëm më i madh.


TENDENȚA
MIGRIMIT

Gjatë vitit të fundit a është larguar ndokush nga Kosova nga rrethi juaj i ngushtë?




Mjedisi i përgjithshëm jo nxitës i shoqërisë kosovare, i dominuar nga paqëndrueshmëria politike, problemet ekonomike, mungesa e mbështetjes institucionale dhe mungesa e sigurisë, i stimulon qytetarët e nacionalitetit serb që të largohen nga Kosova. Hulumtimi i sivjetshëm tregon se çdo i teti i anketuar ka një person nga rrethi i tij që në vitin e fundit është larguar nga Kosova. Shikuar për një periudhë më afatgjate, një nga problemet kryesore të komunitetit social dhe politik të serbëve në Kosovë është shpopullimi, kryesisht përmes largimit të të rinjve.

Gjatë vitit të fundit a është larguar ndokush nga Kosova nga rrethi juaj i ngushtë?




Ashtu si në anketën e vitit të kaluar, numri i personave që theksojnë se dikush nga rrethi i tyre është larguar nga Kosova është më i madh në komunat në jug të Ibrit, sesa në veri të Kosovës. Krahasuar me vitin e kaluar, ka një trend të lehtë në rritje, veçanërisht në komunat në jug të Ibrit.

A e shihni veten në Kosovë në pesë vitet e ardhshme?




Çdo i anketuar i dytë nuk e sheh veten në Kosovë në pesë vitet e ardhshme, ndërsa gjysma tjetër e të anketuarve ose janë duke pritur rastin ose tashmë kanë marrë vendimin për t'u larguar nga Kosova. Kjo e dhënë ka treguar për gjendjen alarmante të keqe në të cilën jetojnë serbët në Kosovë prej vitesh dhe largimi nga Kosova për shumë prej tyre shihet si zgjidhja e vetme. Vëzhguar në mënyrë të segmentuar, të dhënat tregojnë se nuk ka dallim të madh ndërmjet të anketuarve nga veriu i Kosovës dhe atyre në jug të lumit Ibër.

A e shihni veten në Kosovë në pesë vitet e ardhshme?




Do you see yourself in Kosovo for the next five years?



Gjithashtu alarmues dhe shqetësues është fakti se numri më i vogël i të anketuarve që planifikojnë të qëndrojnë në Kosovë i takon brezit më të fuqishëm ekonomikisht dhe nga aspekti social i qytetarëve të moshës 18 deri në 29 vjeç. Vetëm çdo i katërti i anketuar i këtij brezi planifikon të qëndrojë në Kosovë. Tek brezi i parë pasues, ai i moshës 30 deri në 45 vjeç, çdo i dyti i anketuar e sheh veten në Kosovë në pesë vitet e ardhshme. Prandaj, shumica e atyre që duhet të ndërtojnë një të ardhme më të mirë nuk e shohin veten në Kosovë.

	PO			JO			DO TË LARGHEM NËSE MË OFROHET MUNDËSIA		
	2020	2021	2022	2020	2021	2022	2020	2021	2022
SHKOLLA FILLORE	88%	93,8%	92,3%	4%	0%	0%	8%	6,3%	7,7%
SSHKOLLA E MESME	56,4%	46,5%	49%	20,9%	22,9%	22,1%	22,7%	30,6%	29%
SHKOLLA E LARTË	55,2%	62,4%	55,8%	14,6%	15,1%	18,6%	30,2%	22,6%	25,6%
FAKULTETI	41,6%	48,9%	48,2%	26,3%	25,2%	23,5%	32,1%	26%	28,2%


Cila është arsyeja kryesore e largimit tuaj nga Kosova? (nga ata që janë përgjigjur se do të largohen nga Kosova apo planifikojnë të largohen)



Me përmbledhjen e të dhënave të marra për cilësinë e institucioneve dhe jetës në Kosovë, nuk është për t'u habitur që arsyeja kryesore e largimit nga Kosova është pasiguria ekonomike. Çdo i anketuar i dytë është i motivuar nga kjo arsye që të largohet nga Kosova. Arsye tjetër është mungesa e qëndrueshmërisë politik, e cila tashmë po bëhet element folklorik i jetës politike dhe të përditshme të serbëve në Kosovë. Motivimi i tretë dhe i katërt për largimin nga Kosova u shkaktua nga mosrespektimi i të drejtave të serbëve në Kosovë dhe pasiguria personale.


QËNDRIMET NDAJ
BASHKIMIT EVROPIAN

A ju asocion në diçka pozitive apo negative kur së pari dëgjoni “Bashkimi Evropian”?



Në tre vitet e fundit, në mesin e të anketuarve të nacionalitetit serb në Kosovë ka pasur një trend të lehtë të rënies së perceptimit pozitiv dhe një rritje të lehtë të perceptimit negativ për Bashkimin Evropian. Aktualisht, vetëm çdo i dhjeti i anketuar ka një perceptim pozitiv për Bashkimin Evropian. Arsyeja e këtij qëndrimi vjen pikërisht nga perceptimi se Bashkimi Evropian nuk është neutral në procesin e bisedimeve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, por favorizon palën shqiptare. Të dhënat nga disa sondazhe të fundit tregojnë, dhe sondazhi i këtij viti konfirmon, se një përqindje e madhe e të anketuarve besojnë se Bashkimi Evropian e mbështet në bisedime më shumë Prishtinën se Beogradin. Gjithashtu, tabela e mëposhtme tregon arsye të tjera pse serbët e Kosovës nuk e favorizojnë Bashkimin Evropian.

Si e shihni pozicionin e Bashkimit Evropian në procesin e bisedimeve midis Beogradit dhe Prishtinës?




Në një shkallë nga 1 deri në 5, vlerësoni vërtetësinë e pohimeve të mëposhtme:


	NOTA MESATARE		
	2020	2021	2022
BE-ja ka një rol kyç në zgjidhjen e problemeve të komunitetit serb në Kosovë	2,42	2,60	3,35
BE-ja luan një rol kyç në pajtimin ndëretnik në Kosovë	2,24	2,44	2,38
BE-ja investon mjaftueshëm në zonat me shumicë serbe në Kosovë	2,00	2,20	1,89

DISTANCA
ETNIKE

Sa shpesh shkoni në mjediset ku shqiptarët janë shumicë?




Me vëzhgimin e të dhënave nga tri anketat e mëparshme, vërehet se ka një trend të lehtë të kontakteve më të shpeshta, përkatësisht të serbëve që shkojnë në zonat ku shqiptarët janë shumicë. Një ose më shumë herë në javë deri në çdo ditë sot shkojnë rreth 50% e të anketuarve, ndërsa tre vjet më parë kjo përqindje ishte 36%. Të anketuarit që jetojnë në komunat në jug të Ibrit prijnë sa i përket vizitave në zonat me popullsi kryesisht shqiptare, siç mund të shihet nga grafiku 1 më poshtë.



Eksperienca e juaj nga kontakte personale me shqiptarët kryesisht është:


● 2020 ● 2021 ● 2022



Në një shkallë nga 1 deri në 5, vlerësoni marrëdhëniet aktuale ndëretnike në mes të komuniteteve në Kosovë:

	AVERAGE RATING		
	2020	2021	2022
SERBËT DHE SHQIPTARËT	2,23	2,17	2,22
SERBËT DHE BOSHNJAKËT	3,06	3,12	3,12
SERBËT DHE GORANËT	3,65	3,53	3,69

● Serbët dhe shqiptarët ● Serbët dhe boshnjakët ● Serbët dhe goranët



Si në vitet e kaluara, marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve janë vlerësuar më të këqijat, ndërsa marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe boshnjakëve përkatësisht goranëve janë dukshëm më të mira. Kosova, si shoqëri pas konfliktit me çështje të pazgjidhura statusore dhe ndarje etnike, është terren pjellor për ruajtjen e distancës etnike ndërmjet nacionalizmave konkurrues të shqiptarëve dhe serbëve.

Në tabelën para jush janë shtatë kontakte të ndryshme që mund të bëni me pjesëtarët e kombësisë shqiptare.



Analiza e instrumentit që mat distancën etnike ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë tregon shumë pak ndryshime në krahasim me anketën e vitit të kaluar. Format veçanta të marrëdhënieve tregojnë se përkatësia etnike ka efektin më negativ në mundësinë e marrëdhënieve apo raporteve emocionale. Shohim gjithashtu përqindje shumë të larta të distancimit etnik kur janë në pyetje marrëdhëniet politike.

Në një shkallë prej 1 deri në 5, vlerësoni sa respektohen të drejtat tuaja në Kosovë:

	NOTA MESATARE
E drejta për lirinë e lëvizjes	2.63
E drejta e përdorimit të gjuhës	2.53
E drejta për të shprehur përkatësinë kombëtare	2.26
E drejta për të shprehur përkatësinë fetare	2.31
E drejta për lirinë e shprehjes	2.34
E drejta për arsim	2.97

